



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
KOMISIONI I KONKURENCËS**

**VENDIM
nr. 389, datë 14.12.2015**

“Për domosdoshmërinë e marrjes së vlerësimit paraprak të Autoritetit të Konkurrencës për projekt/ligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar””.

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- | | | |
|-----------|-------------|------------|
| ▪ Lindita | MILO (LATI) | Kryetar |
| ▪ Servete | GRUDA | Zv/Kryetar |
| ▪ Koço | BROKA | Anëtar |
| ▪ Iva | ZAJMI | Anëtar |
| ▪ Eduard | YPI | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 14.12.2015, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i projekt/ligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar”.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), neni 24, shkronja f), neni 69 dhe neni 70, pika 2.

Komisioni i Konkurrencës pas vlerësimit të projekt/ligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar”,

VËREN SE:

1. Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), nëpërmjet neneve të tij 69 dhe 70, përcakton shumë qartë rolin e Autoritetit të Konkurrencës në vlerësimin e shkallës së kufizimit apo pengimit të konkurrencës dhe barrierave rregulluese të konkurrencës. Në zbatim dhe respektim të këtij Ligji, për një vlerësim sa më të drejtë dhe specifik të pasojave që mund të vijnë mbi konkurrencën në rastin e dhënies së një ndihme shtetërore, do të ishte i nevojshëm mendimi i Autoritetit të Konkurrencës, si institucioni kompetent në këtë fushë.

2. Komisioni i Ekonomisë dhe i Financave, në rezolutat e vlerësimit të veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës, në mënyrë të vazhdueshme ka kërkuar zbatimin e detyrimit ligjor nga ana e institucioneve publike për marrjen e vlerësimit të Autoritetit të Konkurrencës si një instrument i domosdoshëm për rritjen e eficiencës së përdorimit të pasurisë publike. Më konkretisht Rezoluta për veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2014, cilëson: “Kuvendi i kërkon organeve ekzekutive të të gjitha niveleve të bashkëpunojnë me Autoritetin e Konkurrencës: -

Duke zbatuar detyrimin për të kërkuar paraprakisht vlerësimin ligjor të Autoritetit të Konkurrencës në dhënien e miratimit e akteve që kanë si objekt ose pasojë dhënien e të drejtave ekskluzive ose kufizimeve sasiore në tregje ose sektorë të ndryshëm të ekonomisë.”

3. Sipas legjislacionit të BE-së, kontrolli i ndihmës shtetërore është pjesë e politikës së konkurrencës. Për këtë qëllim UNCTAD (United Nations Conference on Trade and Development) në Raportin e tij “Voluntary peer review of the Albanian Competition Law and Policy” ka dhënë rekomandimet përkatëse lidhur me krijimin e kapaciteteve institucionale për kontrollin efektiv të ndihmës shtetërore.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (f), nenin 69, pika 1, neni 70, pika 2, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar), me propozim të Sekretariatit,

VENDOSI:

1. T’i kërkojë Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit të Shqipërisë:

Të zbatojë nenin 69 të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), duke kërkuar vlerësimin ligjor të Autoritetit të Konkurrencës për çdo projekt akt normativ që potencialisht mund të sjellë kufizime të konkurrencës në tregjet përkatëse.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA

(_____)
Zv/Kryetar

Koço BROKA

(_____)
Anëtar

Iva ZAJMI

(_____)
Anëtar

Eduard YPI

(_____)
Anëtar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R